



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.193

dhjetor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJL
nr.12, datë 14.9.2007

Me objekt kërkimin e pagesës, në favor të trashëgimtarëve ligjorë, të shpërblimit dhe kompensimit të dëmit pasuror dhe jopasuror, shpenzimet e varrimit dhe të tjera të nevojshme e të arsyeshme, të shkaktuar nga aksidenti automobilistik i datës 21.10.2002, në të cilin gjetën vdekjen të ndjerët trashëgimtlënës Jetnor Yska, Rudolf Alimadhi dhe Ibrahim Baliqi..... 6215

VENDIM
Nr.12, datë 14.9.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Artan Hoxha	Kryesues
Gani Dizdari	Anëtar
Ylvi Myrtja	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Agron Lamaj	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Evjeni Sinojmeri	Anëtare
Irma Bala	Anëtare
Shpresa Beçaj	Anëtare
Ardian Dvorani	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar

në seancat gjyqësore të datës 13.9.2007 dhe 14.9.2007 morën në shqyrtim çështjen civile nr.2, që i përket:

PADITËS: SERI YSKA, NEXHMIJE YSKA, XHAFERR ALIMADHI, ATHINA ALIMADHI HYSEN BALIQI, KLARITA BALIQI, përfaqësuar nga Avokat Altin Naqe.

I PADITUR: BYROJA SHQIPTARE E SIGURIMEVE, në mungesë.

OBJEKTI I PADISË: Kërkimin e pagesës në favor të trashëgimtarëve ligjorë të shpërblimit dhe kompensimit të dëmit pasuror dhe jopasuror, shpenzimet e varrimit dhe të tjera të nevojshme e të arsyeshme, të shkaktuar nga aksidenti automobilistik i datës 21.10.2002 në të cilin gjetën vdekjen të ndjerët trashëgimlënës Jetnor Yska, Rudolf Alimadhi dhe Ibrahim Baliqi.

BAZA LIGJORE: Neni 31 i Kodit të Procedurës Civile, nenet 2 e vijues të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”, i miratuar me ndryshime në ligjin nr.7641, datë 1.12.1992, ndryshuar me ligjin nr.8729, datë 19.1.2001, nenet 4 e vijues të rregullores nr.622/1, datë 15.12.1992 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë” dhe nenet 625 e 640 të Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1053, datë 28.2.2005, ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë.

Detyrimin e palës së paditur Byroja Shqiptare e Sigurimit, t’i shpërblejë palës paditëse dëmin e shkaktuar nga përdorimi i mjetit motorik tip veturë, me targë regjistrimi e huaj AN 457856, e drejtuar nga shtetasi Agron Vidhi në masën:

Seri Yska: 1.406.876 lekë, plus vlerën e indeksuar, si dhe interesat mbi këtë shumë sipas ligjit deri në ekzekutimin e vendimit.

Nexhmiye Yska: 1.406.876 lekë, plus vlerën e indeksuar, si dhe interesat mbi këtë shumë sipas ligjit deri në ekzekutimin e vendimit.

Xhafer Alimadhi: 170.000 lekë, plus vlerën e indeksuar, si dhe interesat mbi këtë shumë sipas ligjit deri në ekzekutimin e vendimit.

Athina Alimadhi: 170.000 lekë, plus vlerën e indeksuar, si dhe interesat mbi këtë shumë sipas ligjit deri në ekzekutimin e vendimit.

Hysen Baliqi: 160.000 lekë, plus vlerën e indeksuar, si dhe interesat mbi këtë shumë sipas ligjit

deri në ekzekutimin e vendimit.

Klarita Baliqi: 160.000 lekë, plus vlerën e indeksuar, si dhe interesat mbi këtë shumë sipas ligjit deri në ekzekutimin e vendimit.

Shpenzimet gjyqësore:

Detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë palës paditëse shumë prej 45.000 lekë për aktin e ekspertimit të datës 22.3.2005.

Detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë palës paditëse vlerën 1% të padisë deri në masën 1% të vlerës totale të pranuar nga gjykata në lidhje me padinë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.74, datë, 24.1.2006, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1053, datë 28.2.2005, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 17.5.2007, vendosi kalimin e çështjes në Kolegje të Bashkuara për unifikimin e praktikës gjyqësore.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin e anëtarëve Artan Hoxha dhe Ardian Dvorani, mbrojtësin e palëve paditëse, që kërkoi ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit duke pranuar plotësisht padinë në të gjitha kërkimet e saj; pasi biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Rezulton nga aktet dhe vendimet e dhëna në të dyja shkallët e gjykimit se paditësit Seri Yska e Nexhmije Yska, Xhafer Alimadhi e Athina Alimadhi, Hysen Baliqi e Klarita Baliqi, janë përkatësisht prindërit e të ndjerëve Jetnor Yska, Rudolf Alimadhi dhe Ibrahim Baliqi.

Mbështetur në tërësinë e provave të administruara e debatuar në gjykim, përfshirë aktekspertimet autoteknike dhe ato mjeko-ligjore, gjykatat e faktit kanë pranuar se të ndjerët e lartpërmendur kanë humbur jetën për shkak të aksidentit automobilistik të ndodhur në datën 21.10.2002 në rrugën kombëtare Fier-Seman. Kjo ngjarje është shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe me faj nga shtetasi Agron Vidhi, i cili, me vendim gjyqësor të formës së prerë, është deklaruar fajtor për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen e tre personave dhe atë të largimit nga vendi i aksidentit, duke marrë dënimin penal përkatës.

Si në gjykimin penal, ashtu edhe gjatë këtij gjykimi është vërtetuar se i dënuari, përkatësisht edhe personi përgjegjës civilisht për shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor, duke drejtuar një mjet motorik, ka aksidentuar me pasojë vdekjen e të ndjerëve Jetnor Yska, Rudolf Alimadhi dhe Ibrahim Baliqi, përkatësisht të moshës 31, 13 dhe 12 vjeç. Viktimat kanë qenë duke lëvizur jashtë rrugës, në trotuar.

Mjeti motorik tip veturë "Alfa Romeo", me targa të huaja AN 457856, ishte i pasiguruar me karton jeshil apo me një policë tjetër sigurimi, sipas legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike. Prandaj, në zbatim të shkronjës "b" të nenit 17 të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 "*Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë*" (miratuar me ndryshime me ligj), për mbulimin e përgjegjësisë civile dhe dëmshpërblimin përkatës të dëmit të shkaktuar të tretëve, është e ngarkuar Byroja Shqiptare e Sigurimit, nëpërmjet Fondit të Kompensimit të administruar për këtë qëllim nga ana e saj.

Në rrethana të tilla, mbështetur në nenin 15 të Kushtetutës, nenin 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 17 e 24 të dekretit nr.295, datë 15.9.1992, nenet 625, 640 e vijues të Kodit Civil, nenin 192 të Kodit të Familjes etj., paditësit kanë ngritur padi duke thirrur si të paditur Byronë Shqiptare të Sigurimit. Paditësit kërkojnë detyrimin e të paditurit t'i dëmshpërblejë, si trashëgimtarë ligjorë të viktimave, për dëmet pasurore dhe jopasurore të shkaktuara nga aksidenti me pasojë vdekjen e bijve të tyre, të ndjerëve Jeton Yska, Rudolf Alimadhi dhe Ibrahim Baliqi.

Paditësit pretendojnë se kanë pësuar cenime të rënda të shëndetit, të personalitetit të tyre, në marrëdhëniet dhe interesat familjare, si në aspektin pasuror dhe atë jopasuror. Prandaj kërkojnë rikthimin e gjendjes përpara aksidentit, sikur vdekja e të ndjerëve të mos kishte ndodhur, duke u detyruar i padituri

t'u dëmshpërblejë humbjet pasurore nga pakësimi i të ardhurave në familje, si dhe dëmet e tjera jopasurore shëndetësore për vuajtjen shpirtërore, cenimin e vlerave e të cilësisë së jetës familjare e personale (private) të tyre. Padiësit kërkojnë dëmshpërblimin e shpenzimeve të varrimit, ato për përkujdesje e kurim shëndetësor të familjarëve të traumatizuar nga ngjarja, si dhe shpenzimet e mbrojtjes gjyqësore, duke i llogaritur të gjitha dëmshpërblimet së bashku me interesat në kohën e ekzekutimit të detyrimit.

Nga ana tjetër, në gjykim pala e paditur pranon se ka ndodhur një aksident automobilistik për shkak të veprimeve të paligjshme e me faj të shtetasit Agron Vidhi në drejtimin e mjetit motorik, si dhe shkaktimin e vdekjes së të ndjerëve, si pasojë e drejtpërdrejtë e sjelljes së paligjshme të tij. I padituri pranon thirrjen e tij në këtë gjykim në cilësinë e të paditurit për shkak të legjitimitetit pasiv që rrjedh nga dispozitat ligjore që e ngarkojnë me detyrimin për dëmshpërblimin e dëmeve të pësuar nga të tretë për shkak të drejtimit të një mjeti motorik të pasiguar.

Në gjykim pala e paditur ka pranuar detyrimin për dëmshpërblimin e shpenzimeve të varrimit për të gjithë padiësit, si dhe të shpenzimeve për ushqim e jetesë (neni 643/a i Kodit Civil) vetëm për padiësit Seri dhe Nexhmije Yska, prindër të të ndjerit Jetnor, sipas kriterit të trefishit të shumës vjetore të pensionit më të ulët në sigurimet shoqërore, të parashikuar në nenin 27 të rregullores nr.622/1, datë 15.12.1992 të Ministrisë të Financave.

Ndërkohë i padituri ka prapësuar kërkimet e padiësve të tjerë për dëmshpërblimin e shpenzimeve për ushqim e jetesë duke pretenduar se dy të ndjerëve të mitur u ndalohej me ligj punësimi, prandaj nuk mund të realizonin të ardhura që të legjitimonin kërkimin e prindërve të tyre sipas nenit 643 të Kodit Civil. Së fundi, i padituri prapëson në tërësinë e tyre kërkimet e të gjithë padiësve për dëmshpërblimin e dëmeve jopasurore me pretendimin se në këtë gjykim gjejnë zbatim dispozitat e posaçme mbi sigurimin e detyrueshëm, sipas të cilave, në rastin e dëmeve të shkaktuara nga mjeti motorik i pasiguar paguhen vetëm vdekja, dëmtimi i shëndetit dhe dëmet pasurore (neni 17 i dekretit), të cilat duhet të kuptohen si cenime, dëme direkt në vetë pasurinë (sendet) dhe shëndetin e të aksidentuarve.

Përpara se Kolegjet e Bashkuara të arsyetojnë qëndrimin e tyre ligjor për efekte të unifikimit të praktikës gjyqësore dhe zgjidhjen e çështjes, çmojnë se është vendi të trajtohet qëndrimi ligjor i mbajtur në vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë dhe e apelit në lidhje me kërkimet e prapësimet e palëve ndërgjyqëse.

Gjykata e shkallës së parë ka lejuar palët ndërgjyqëse të debatojnë lidhur me kërkimet e prapësimet dhe provat e paraqitura në mbështetje të tyre, si dhe ka thirrur ekspertë për të dhënë mendim teknik për mënyrën e llogaritjes së dëmshpërblimit të dëmit pasuror e jopasuror të kërkuar në padi.

Gjykata arsyeton se padiësit kanë legjitimitet aktiv të kërkojnë shpërblimin e dëmeve pasurore e jopasurore si *trashëgimtarë ligjorë*, prindër të të ndjerëve që kanë humbur jetën në aksidentin automobilistik të shkaktuar nga sjellja e paligjshme dhe me faj e drejtuesit të mjetit motorik. Ndërsa i padituri ka legjitimitet pasiv për shkak se legjislacioni i fushës së sigurimeve të detyrueshme e ngarkon me detyrimin për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga mbajtës të mjeteve motorike të pasiguar.

Lidhur me mosmarrëveshjen dhe kërkimet e padisë, gjykata arsyeton se gjejnë zbatim rregullimet e përgjithshme të Kodit Civil, si dhe rregullimet e posaçme të legjislacionit mbi dëmet jashtëkontraktore të shkaktuara të tretëve nga mjetet motorike. Neni 608 i Kodit Civil parashikon dëmshpërblimin për dëmet jashtëkontraktore të pësuar nga vetë i dëmtuari "*në personin ose në pasurinë e tij*" dhe jo ato të pësuar në shëndetin a pasurinë e të tretëve. Të njëjtin arsyetim gjykata bën edhe për kuptimin e dispozitave të neneve 17 e 18 të dekretit nr.295, datë 15.9.1992. Prandaj gjykata arrin në përfundimin se, përjashtimisht, vetëm për rastin e vdekjes, pasjetuesve të viktimës u dëmshpërblehen në cilësinë e "*trashëgimtarit*" dëmet pasurore të shpenzimeve për ushqim e jetesë dhe shpenzimet e varrimit, sipas shkronjave "a" e "b" të nenit 643 të Kodit Civil.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, gjykata ka vendosur të pranojë pjesërisht padinë sipas dispozitivit, duke i dëmshpërblyer secilit padiës vetëm dëmin pasuror lidhur me vdekjen e të ndjerëve, përkatësisht për padiësit Yska shpenzimet për ushqim e jetesë dhe shpenzimet e varrimit, ndërsa për padiësit e tjerë vetëm shpenzimet e varrimit.

Gjykata ka pranuar padinë për kërkimin e dëmshpërblimit në formën e shpenzimeve për ushqim e jetesë vetëm për dy nga padiësit, prindërit e të ndjerit Jetnor Yska, për shkak se ishte madhor, ndonëse i

papunë në kohën e vdekjes. Ndërsa ka rrëzuar padinë për të njëjtin kërkim të paditësve të tjerë, prindër të dy të ndjerëve të mitur nën moshën 14 vjeç, sepse nuk plotësohen kriteret e shkronjës “a” të nenit 643 të Kodit Civil. Nisur nga mosha e të ndjerëve nuk bëhet fjalë për *“fëmijë të tyre të mitur”*, *“bashkëshortë”* apo *“prindër të paaftë në ngarkim të tyre”* dhe as për detyrime të tyre për ushqim e jetesë kundrejt personave që banonin në një familje me ta e që do të gëzonin këtë të drejtë ndaj viktimave. Të ndjerët, për shkak të moshës nën 14 vjeç, nuk kishin zotësi për të vepruar dhe sipas ligjit *u ndalohej të punonin*. Së fundi, edhe sipas neneve 192 e 198 të Kodit të Familjes, nuk ka vend për lindjen e detyrimit për ushqim sepse paditësit, prindërit e të ndjerëve Alimadhi e Buliqi, nuk provuan se ishin *“të paaftë për punë dhe pa mjete të mjaftueshme për jetesë”*.

Së fundi, gjykata ka çmuar të pabazuar në ligj kërkimet e padisë në lidhje me shpërblimin e dëmeve jopasurore. Nga njëra anë arsyeton se humbja e jetës së fëmijës është ngjarje e rëndë dhe mjaft e dhimbshme, që rëndon gjendjen shpirtërore të të afërmeve të viktimës, pra përbën dëm jopasuror sipas nenit 625 të Kodit Civil. Por, nga ana tjetër, ka çmuar se, sipas neneve 17 e 18 të dekretit nr.295, datë 15.9.1992, dëmshpërblehet *“vdekja, dëmtimi i shëndetit dhe dëmet pasurore...”* të pësura nga vetë të dëmtuarit në aksidentin automobilistik. Këto dispozita, në përjashtim nga rregullat e përgjithshme të Kodit Civil, parashikojnë në mënyrë taksative vetëm dëmshpërblimin e dëmeve pasurore duke u përjashtuar dëmet jopasurore sipas nenit 625 të Kodit Civil.

Gjykata e apelit, e investuar mbi ankimin e paditësve, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me një arsyetim të njëjtë, por më të përmbledhur krahasuar me këtë të fundit.

Në rekursin e parashtruar në Gjykatën e Lartë paditësit pretendojnë se gjykatat e faktit nuk kanë kryer një hetim gjyqësor të plotë e të gjithanshëm dhe kanë zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin. Kërkimet e padisë kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave themelore të njeriut, ku bën pjesë edhe e drejta produktive e individit, aftësia e tij për të prodhuar të ardhura. Gjykatat kanë zbatuar gabim nenin 643/a të Kodit Civil në lidhje me nenin 192 të Kodit të Familjes, aty ku bëhet fjalë *“për personat që banonin në familjen e të vdekurit dhe gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit”*. Gjykatat ngatërrojnë *“aftësinë për të prodhuar të ardhura”* me *“të drejtën për të punuar”* dhe ndalimet përkatëse.

Po kështu, në rekurs paditësit pretendojnë se gjykatat, duke zbatuar keq ligjin kanë kufizuar rrethin e subjekteve të cenuar vetëm tek ata që dëmtohen në shëndetin e tyre në ngjarjen e paligjshme. Ndërkohë që Kushtetuta, neni 625 i Kodit Civil dhe legjislacioni i sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike, njohin të drejtën e të afërmeve të viktimës së aksidentit për shpërblimin e dëmit jopasuror të pësuar në formën e *“dëmtimit të shëndetit”*. Ky *“dëmtim i shëndetit”* përfshin jo vetëm cenimin e shëndetit në kuptimin e ngushtë të tij, por edhe cenimin e të drejtave për një jetë normale private e familjare e pa dhimbje shpirtërore.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 17.5.2007, nisur nga qëndrimet e ndryshme të gjykatave në raste analoge me çështjen në gjykim përsa i përket zbatimit të ligjit lidhur me rrethin e personave të dëmtuar, të drejtën e përfitimit të dëmshpërblimit për dëmet jashtëkontraktore dhe mënyrën e llogaritjes së tij, veçanërisht atyre jopasurore, ka çmuar se është vendi të mbahet një qëndrim i unifikuar, duke e dërguar çështjen për shqyrtim para Kolegjeve të Bashkuara, ku parashtrihen për zgjidhje këto çështje:

1. Në rastin e aksidenteve automobilistike në kuptim të dekretit nr.295, datë 15.9.1992, kur i aksidentuar është një i mitur i cili nuk ka në ngarkim persona të tjerë, a duhet të përfitohet shpërblim për shpenzimet për mbajtje me ushqim e jetesë të familjarëve të tij duke pasur parasysh edhe formulimin e dispozitës së nenit 643 shkronja “a” të Kodit Civil.

2. Nëse përfitojnë shpërblim për dëmin jo pasuror familjarët e viktimave në kuptim të nenit 625 të Kodit Civil, parë kjo e lidhur me dekretin nr.295, datë 15.9.1992 dhe me nenin 44 të Kushtetutës.

3. Çfarë do të konsiderohet dëm jopasuror dhe kush janë kriteret e përcaktimit të tij në këto raste, referuar edhe legjislacionit në fushën e sigurimeve të mjeteve motorike?.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se orientimi i palëve nga gjykata në përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes, parashtrimin e kërtimeve e prapësimeve sipas të drejtës së zbatueshme dhe të provave të domosdoshme për gjykimin e padisë për kërkimin e dëmshpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, është thelbësor për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Hetimi gjyqësor fillimisht orientohet në parashtrimin e

pretendimeve e prapësimeve në lidhje me vërtetimin e ngjarjes së dëmit dhe dinamikës së tij, sjelljes së paligjshme dhe fajësisë së shkaktuesit të dëmit, si dhe ardhjen e pasojave të dëmshme për shkak të tyre. Në vijim, palët orientohen të debatojnë lidhur me cenimet (dëmet) konkrete të pësuar, rrethin e personave të cenuar dhe masën përkatëse të dëmshpërblimit.

Në gjykim rezulton se gjykata ka lejuar palët ndërgjyqëse të debatojnë e paraqesin prova në mbështetje të kërtimeve e prapësimeve të tyre. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore dhe në gjykimin penal rezulton e vërtetuar se është konsumuar *fakti i paligjshëm* në të tri elementet objektive e subjektive të tij: ngjarja e dëmit nga sjellja e paligjshme (*non iure*) dhe me faj (*culpa*) të të tretit, si dhe shkaktimi i vdekjes së viktimave prej saj. Prandaj, me të drejtë gjykata e shkallës së parë nuk ka çmuar të thërrasë ekspertë për konstatimin dhe sqarimin e këtyre rrethanave të faktit. Në vijim, gjykata ka çmuar të caktojë grupe ekspertësh për të dhënë mendim të specializuar në funksion të përcaktimit dhe llogaritjes së vlerës së dëmit pasuror e jopasuror të kërkuar me anë të padisë.

Por, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se gjykatat e faktit, duke zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin, nuk kanë zhvilluar një hetim të plotë e të gjithanshëm, duke mbajtur edhe qëndrime në vetvete kontradiktore, lidhur me qëllimin dhe kuptimin e dëmshpërblimit të dëmit jashtëkontraktor pasuror dhe jopasuror, figurat përkatëse të secilës kategori dëmi, rrethin e subjekteve të cenuara që legjitimohen të kërkojnë dëmshpërblimin, kriteret e pranimit dhe caktimit të masës së dëmshpërblimit, lidhjen shkakësore, mjetet provuese dhe barrën e provës, si dhe për rolin e gjykatës në shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Në rrethana të tilla, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të parashtrojnë qëndrimin e tyre ligjor lidhur me të gjitha kërkimet e padisë dhe qëndrimet përkatëse të mbajtura nga gjykatat e faktit si në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, ashtu edhe për zgjidhjen e çështjes në gjykim.

1. Në rekurs, sikurse edhe gjatë gjykimit, paditësit pretendojnë se me anë të kërkesëpadisë kanë parashtruar kërtime duke paraqitur provat përkatëse *për detyrimin e të paditurit që t'i dëmshpërblejë për (të gjitha) dëmet pasurore dhe jopasurore, shpenzimet e varrimit dhe të tjera të nevojshme e të arsyeshme*, të shkaktuara nga aksidenti automobilistik, ku humbën jetën fëmijët e tyre, duke u mbështetur në nenin 608 e vijues të Kodit Civil, dispozitat e Kodit të Familjes dhe legjislacionin për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj të tretëve.

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore dhe vendimet e dhëna në të dyja shkallët e gjykimit konstatohet se gjykatat nuk kanë orientuar palët për sqarimin e vullnetit dhe dallimin e elementeve konkrete të kërtimeve të padisë që duhet t'i nënshtrohen debatit gjyqësor. Prandaj *gjykatat nuk kanë kryer hetim të plotë gjyqësor duke mos vënë në bisedim apo duke mos i dhënë përgjigje ezauruese kërtimeve në lidhje me llojet e ndryshme të dëmit pasuror e jopasuror të pësuar nga paditësit*.

Ky qëndrim i gjykatave nuk është i mbështetur në ligj. Prandaj, nisur nga parimet themelore të gjykimit të mosmarrëveshjeve civile, si dhe nga vetë natyra e interesave të ligjshme të mbrojtura në padinë për kërkimin e dëmshpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: **Në gjykimet me objekt detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit, nëse paditësi kërkon dëmshpërblimin “për të gjitha dëmet” apo “për të gjitha dëmet pasurore e jopasurore”, kjo mënyrë kërkiti përbën disponimin e tij për kërkimin e dëmshpërblimit për çdo figurë të dëmit pasuror e jopasuror. Por, nëse kërkesëpadia përmban kërtime për dëmshpërblimin e figurave konkrete të dëmit jashtëkontraktor, gjykata ka detyrimin t'i përmbahet në gjykim dhe vendim këtyre kërtimeve specifike. Megjithatë, gjykata duhet të orientojë e kërkojë nga palët të japin shpjegime rreth natyrës së mosmarrëveshjes në funksion të qartësimit të kërtimeve e prapësimeve mbi të drejtat dhe interesat e ligjshme të cenuara.**

2. Në rekurs, sikurse gjatë gjykimit, paditësit pretendojnë se gëzojnë legjitimitet aktiv *edhe si të dëmtuar*, pra si persona që kanë pësuar dëme pasurore dhe jopasurore nga humbja e jetës së viktimave për shkak të aksidentit automobilistik, por *edhe si trashëgimtarë ligjorë të tyre*, madje duke paraqitur si provë edhe dëshmitë përkatëse të trashëgimisë. Nga ana tjetër, në gjykim dhe në vendimet e dhëna, gjykatat janë fokusuar në *pranimin e legjitimitetit aktiv të paditësve duke u nisur kryesisht nga cilësia e tyre si trashëgimtarë ligjorë të të ndjerëve*.

Ky qëndrim i gjykatave përbën zbatim të gabuar të ligjit përsa i përket kuptimit dhe qëllimit të institutit juridiko-civil të dëmit jashtëkontraktor, i cili ka ndikuar dukshëm edhe në ndërtimin e ndërgjyqësisë dhe qëndrimin e gabuar e konfuz të tyre ndaj kërtimeve të padisë sipas shkakut ligjor dhe

objektit të saj.

Një nga parimet themeltare të bashkëjetesës në shoqërinë njerëzore është ndalimi për t'i shkaktuar dëm tjetrit (*alterum non laedere ose neminem laedere*). Zbatimi i tij gjen rregullim të përgjithshëm në Kodin Civil dhe në veçanti në dispozitat mbi përgjegjësinë civile jashtëkontraktore të parashikuara nga nenet 608 e vijues të tij. Në bazë të kësaj përgjegjësie, e njohur si “përgjegjësia akuilane” (*lex Aquilia de damno*), cilido që shkel të drejtat dhe interesat e ligjshme të një tjetri detyrohet ta dëmshpërblejë atë. Nëpërmjet dëmshpërblimit synohet pikërisht rivendosja e plotë e të dëmtuarit (*restitutio in integrum*) në gjendjen e mëparshme (*status quo ante*) në të cilën ai do të gjendej nëse nuk ndodhte fakti i paligjshëm.

Prandaj, në zbatim të neneve 608, 625, 643/a e vijues të Kodit Civil, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë të unifikojnë se: **Çdo subjekt i cenuar në të drejta dhe interesa të ligjshme personale e pasurore nga fakti i paligjshëm, edhe nëse nuk është ai vetë subjekti pasiv i atij fakti, ka të drejtën subjektive, legjitimimin aktiv për të kërkuar (ius proprius) dëmshpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të pësuar. Ky legjitimim aktiv, në parim, nuk kushtëzohet me gëzimin e cilësisë së trashëgimitarit të një personi të dëmtuar, por vetëm me cilësinë e vetë paditësit si i dëmtuar, nga fakti i paligjshëm.**

Në rastin e shkaktimit të vdekjes nga fakti i paligjshëm, sikurse ka ndodhur në çështjen objekt i këtij gjykimi, kanë legjitimim aktiv për kërkimin e dëmshpërblimit të dëmit pasuror e jopasuror të pësuar pjesëtarët e familjes së viktimës. Në rastin e dëmtimit të shëndetit, legjitimim aktiv ka vetë personi i cenuar në shëndetin e tij dhe, sipas rrethanave, edhe pjesëtarët e afërt të familjes së tij. Në të dy rastet, legjitimim aktiv gëzon edhe personi që pretendon se bashkëjetonte me viktimën pa lidhur martesë me të (*more uxorio*) dhe, në rrethana përjashtimore, edhe persona të tjerë në lidhjen më të afërt të gjinisë a krushqisë me viktimën.

Gjykata, nëse pranon padinë, nuk mjaftohet vetëm me caktimin e dëmshpërblimit në një shumë të përgjithshme për të gjithë rrethin e personave që legjitimohen si të dëmtuar. Ajo cakton edhe dëmshpërblimin përkatës për secilin të dëmtuar, në raport me shkallën individuale, konkrete, të cenimit të të drejtave dhe interesave të tij nga fakti i paligjshëm.

3. Në rekurs, paditësit pretendojnë se gjykatat kanë zbatuar keq ligjin duke i pranuar vetëm pjesërisht kërkimet e padisë. Sipas paditësve, me anë të padisë është kërkuar shpërblimi i dëmit pasuror e jopasuror të pësuar, sepse janë cenuar të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme për shkak të humbjes së jetës së fëmijëve nga veprimet e paligjshme e me faj të shkaktuesit të dëmit. Paditësit pretendojnë se gjykatat kanë zbatuar gabim nenin 608 të Kodit Civil në lidhje me nenin 18/b të dekretit nr.295, datë 15.9.1992, sipas të cilit paguhen “vdekja, dëmtimi i shëndetit dhe dëme pasurore...”, kur arsyetojnë se shpërblehet vetëm dëmi i shkaktuar “në personin e tij” dhe “në pasurinë e tij”, pra vdekja, dëmtimi i shëndetit dhe i pasurisë që pëson vetë personi dhe jo dëmet në personin a pasurinë e atyre që janë trashëgimtarë të viktimës.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se pretendimi i paditësve mbështetet në ligj, ndërsa qëndrimi i gjykatave përbën zbatim të gabuar të tij, jo vetëm për kuptimin ligjor të dëmit jashtëkontraktor, rrethit të të dëmtuarve dhe së drejtës e interesit të cenueshëm nga fakti i paligjshëm, por edhe përse i përket lidhjes shkakësore ndërmjet faktit të paligjshëm dhe dëmit të pësuar.

Sipas nenit 608 të Kodit Civil, “Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin dhe pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar”. Kjo dispozitë parashikon faktin juridik njerëzor të sjelljes së paligjshme dhe me faj të një personi që i shkakton dëm një personi tjetër. Nëse vërtetohet fakti i paligjshëm dhe lidhja shkakësore e tij me dëmin, lind marrëdhënia e detyrimit, e drejta subjektive e personit të dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim dhe detyrimi i personit përgjegjës për ta shlyer atë. Në interpretim të kësaj dispozite, me shkaktim të dëmit “në personin ose në pasurinë” e të dëmtuarit kuptohet jo vetëm lidhja ndërmjet tij dhe dëmit, por edhe dallimi ndërmjet cenimeve të natyrës pasurore dhe atyre jopasurore në të drejta dhe interesa të ligjshme të të dëmtuarit.

Nga ana tjetër, në bazë të nenit 18 të dekretit nr.295, datë 15.9.1992, parashikohet se paguhen “jeta, dëmtimi i shëndetit dhe dëme pasurore...”. Kjo dispozitë synon të përcaktojë këto tri lloje faktesh të paligjshme, si aksidente rrugore, ngjarje dëmi, me vërtetimin e të cilave të dëmtuarit mund t'i shkaktohen cenime të një a më shumë të drejtave subjektive konkrete, me natyrë pasurore ose jopasurore apo të dyja së bashku.

Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se: **Në thelb, me dispozitën e nenit 608 të Kodit Civil dhe atë të nenit 18 të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 ligjvënësi parashikon mbrojtjen nga fakti i paligjshëm i të tretit të të drejtave të njeriut, posaçërisht të të drejtave subjektive (absolute a relative) të personalitetit dhe të pronësisë (reale), sikurse janë e drejta e jetës, shëndetit, personalitetit, dinjitetit, familjes, jetës private, pronës etj. Në rast të cenimit të këtyre të drejtave nga fakti i paligjshëm, i dëmtuari gëzon të drejtën subjektive relative të kërimit të dëmshpërblimit jashtëkontraktor.**

Në këtë kuptim, “vdekja”, sipas dispozitës së nenit 18/b të dekretit, është vetë fakti i paligjshëm që shkakton dëmin “*në personin*” e të dëmtuarit (neni 608 i Kodit Civil). Në këtë rast, sikurse janë edhe rrethanat e çështjes objekt i këtij gjykimi, krahas dhunimit të së drejtës themelore të viktimës për jetën, cenohen sipas rastit edhe të drejta themelore të personave të tjerë të lidhur me të, ku bëjnë pjesë edhe paditësit si prindër të viktimave. Këto cenime shkaktohen në të drejtat e personalitetit apo të pasurisë së tyre, përkatësisht në forma të ndryshme të dëmit jopasuror apo pasuror. I njëjti interpretim vlen edhe për “*dëmtimin e shëndetit*” sipas nenit 18/b të dekretit. Në këtë rast, i dëmtuari në shëndetin e tij mund të cenohet njëkohësisht si në të drejta pasurore (neni 641 i Kodit Civil), ashtu edhe jopasurore (dëmtimi i shëndetit dhe ai i personalitetit - neni 625/a, Kodit Civil). Por, krahas “*dëmtimit të shëndetit*” të këtij personi, sipas rrethanave të faktit, mund të cenohen në të drejtat personale e pasurore edhe persona të tjerë të lidhur me të.

4. Jo vetëm për çështjet e mësipërme, por edhe në tërësi, në zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat në lidhje me kërkimet e padisë objekt i këtij gjykimi, vlerësohet se ka ndikuar në mënyrë vendimtare kuptimi dhe zbatimi i gabuar i ligjit në lidhje me institutin juridik të lidhjes shkakësore. Edhe në praktikën gjyqësore për zgjidhjen e çështjeve analoge vërehen qëndrime të ndryshme ligjore nga gjykatat. Prandaj Kolegjet e Bashkuara çmojnë se është vendi për të marrë në shqyrtim thelbin e kuptimit të institutit juridik të lidhjes shkakësore dhe të zbatimit të drejtë të tij për zgjidhjen e çështjeve me objekt përgjegjësinë civile jashtëkontraktore.

Në nenin 13 të Kodit Penal parashikohet se: “*Askush nuk ka përgjegjësi penale kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore*”. Ndërsa në nenin 609 të Kodit Civil parashikohet se: “*Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit*”.

Sipas dispozitave të sipërcituara, vërtetimi i lidhjes shkakësore është kusht thelbësor, përkatësisht, për pranimin e përgjegjësisë penale dhe të asaj civile të autorit të faktit të paligjshëm, si dhe për caktimin e dënimit penal e të detyrimit civil përkatës. Por, ndërmjet të tjerave, në të drejtën penale, interesi i ligjshëm mbrohet nëse parashikohet në mënyrë të shprehur nga një dispozitë konkrete e ligjit dhe ku personi i dëmtuar është vetë titullari i së drejtës së cenuar. Ndërsa në përgjegjësinë civile jashtëkontraktore, interesi i ligjshëm mbrohet në çdo rast, nëse cenohet si pasojë e çfarëdolloj veprimi a mosveprimi që vërtetohet se është i paligjshëm dhe i kryer me faj nga autori i tyre, ku personi i dëmtuar nuk është, në kuptimin material, domosdoshmërisht dhe drejtpërdrejt subjekti pasiv i sjelljes së paligjshme të shkaktesit të dëmit.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: **Në zbatim të nenit 609 të Kodit Civil, për pranimin e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) së paligjshme e me faj dhe dëmit të shkakuar. Në vijim, për përcaktimin e dëmtimeve (cenimeve) konkrete që rrjedhin nga ky fakt i paligjshëm dhe caktimin e dëmshpërblimit përkatës, duhet të vërtetohet edhe lidhja shkakësore juridike ndërmjet tyre.**

Nëpërmjet lidhjes shkakësore materiale, vërtetohet se cili është personi përgjegjës (subjekti aktiv) dhe lidhja shkak-pasojë ndërmjet tri elementeve objektive e subjektive të faktit të paligjshëm (ngjarjes së dëmit): sjelljes së paligjshme (objektiv) e me faj (subjektiv) dhe pasojës së ardhur prej tyre, pra dëmtimit të një tjetri në personin a pasurinë e tij (objektiv). Në këtë rast zbatohet parimi juridik *condicio sine qua non*, sipas të cilit ardhja e pasojës së dëmshme nuk do të vërtetohej nëse nuk do të kishte ndodhur shkak, sjellja e paligjshme dhe me faj e personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit.

Ndërsa me lidhjen shkakësore juridike vërtetohet lidhja shkak-pasojë ndërmjet faktit të paligjshëm në tërësinë e tij dhe cenimeve konkrete të pësura në të drejta dhe interesa të ligjshëm, si të subjektit pasiv mbi të cilin ka vepruar direkt ky fakt i paligjshëm, ashtu edhe të personave të tjerë, që rezultojnë të dëmtuar, si rrjedhojë e pasojave që pranohet se vijnë normalisht e zakonisht nga i njëjti fakt i paligjshëm, sipas parimeve të rregullshmërisë dhe efikasitetit të lidhjes shkakësore (*id quod plerumque accidit*).

Në këtë kuptim, lidhja shkakësore nuk ndërpritet nëse pas vërtetimit të faktit të paligjshëm dhe pasojës “natyrale”, “materiale”, të ardhur prej tij, pra dëmtimit (cenimit) të interesave të ligjshme të subjektit pasiv nga sjellja e shkaktuesit të dëmit, vijnë e vërtetohen fakte të reja me pasoja të dëmshme, të cilat konsiderohen të lidhura e rrjedhojë direkt dhe e menjëhershme e të njëjtë fakt të paligjshëm, përderisa provohet që nëse ky nuk ndodhte, fakti i ri, i mëvonshëm, në vetvete, nuk mund të shkaktonte edhe ai të njëjtën pasojë të dëmshme.

Në rastin e çështjes objekt gjykimi rezulton që si palët ndërgjyqëse, ashtu edhe gjykatat pranojnë se vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes së paligjshme e me faj të drejtuesit të mjetit motorik dhe pasojës së kësaj ngjarjeje dëmi, vdekjes së bijve të paditësve. Por, me përjashtim të shpenzimeve për ushqim e jetesë për paditësit Yska, si dhe të shpenzimeve të varrimit për të gjithë paditësit, gjykatat nuk kanë pranuar kërkimet e tjera të padisë. Duke arsyetuar në mënyrë të gabuar se Kodi Civil dhe dekreti nr.295, datë 15.9.1992 njohin vetëm dëme të pësura në vetë personin dhe pasurinë e të dëmtuarit nga aksidenti dhe jo te të tretët, gjykatat kanë arritur në përfundimin tjetër të gabuar se nuk vërtetohet lidhje shkakësore materiale ndërmjet sjelljes së paligjshme të shkaktuesit të dëmit dhe pasojave të dëmshme që palët paditëse pretendojnë se i kanë vuajtur vetë për shkak të kësaj sjelljeje.

Ky qëndrim i gabuar i gjykatave vjen ndesh në parim me vetë institutin e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore, sipas të cilit kushdo që i shkakton dëm të tretëve detyrohet ta dëmshpërblejë atë (*neminem laedere*). Duke rrëzuar kërkimet e paditësve, gjykatat nuk kanë zbatuar drejt lidhjen shkakësore juridike, vërtetimin e lidhjes shkak-pasojë ndërmjet faktit të paligjshëm (veprimit të paligjshëm, me faj, të autorit të aksidentit me pasojë vdekjen e fëmijëve) dhe pasojave të tjera konkrete të cenimit të interesave të ligjshme pasurore apo jopasurore të të afërmeve të viktimave (paditësve).

Nga gjykatat e faktit duhet të pranohet *ius receptum*, si e vërtetuar ligjërisht, me anë të prezumimeve të thjeshta, kërkitimi i paditësve se ata, si prindër (apo të afërmi familjarë) të viktimave, i vuajnë vetë normalisht dhe zakonisht pasojat e një ngjarjeje dëmi të kësaj natyre. Presumohet se vdekja e të ndjerëve nga fakti i paligjshëm (aksidenti), në moshë të re e të mitur, sjell si pasojë shuarjen e marrëdhënieve prindërore dhe të gjinisë me paditësit e të afërmit familjarë të tyre, si rrjedhojë, edhe cenimin e interesave të ligjshme jopasurore që lidhen me personalitetin e pasjetuesve, si cilësia e jetës, paprekshmëria e familjes, solidariteti reciprok, dhimbja e vuajtja shpirtërore e tyre etj. Ndërkohë që paditësit duhet të vërtetojnë me mjete të tjera provuese lidhjen shkakësore juridike ndërmjet këtij fakti të paligjshëm dhe cenimeve në formën e dëmtimit të shëndetit të vuajtura prej tyre apo në formën e dëmeve të tjera me natyrë pasurore. Në këtë lloj gjykimi i mbetet të paditurit barra e provës të vërtetojë të kundërtën, përndryshe kërkimet e paditësve çmohet se janë vërtetuar.

5. Paditësit në rekurs pretendojnë se duke zbatuar gabim ligjin gjykatat kanë rrëzuar kërkimin e padisë për shpërblimin e dëmit pasuror në formën e shpenzimeve për ushqim e jetesë për shkak të vdekjes së fëmijëve të mitur (neni 643/a i Kodit Civil). Sipas tyre janë cenuar të drejta themelore të njeriut, sikurse është e drejta produktive e individit si aftësi e kapacitet për të prodhuar të ardhura, ndërkohë që gjykatat ngatërrojnë “*aftësinë për të prodhuar të ardhura*” me lejin a ndalimin e së drejtës “*për të punuar*”.

Lidhur me këtë kërkim, të dyja gjykatat e faktit arsyetojnë se të drejtën e dëmshpërblimit për shpenzimet për ushqime e jetesë sipas shkronjës “a” të nenit 643/a të Kodit Civil e gëzojnë vetëm trashëgimtarët ligjorë të viktimës që ka qenë madhor në kohën e vdekjes.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se ky qëndrim përbën zbatim të gabuar të ligjit si përsa i përket kuptimit të dëmit pasuror sipas neneve 486 e 608 të Kodit Civil, ashtu edhe qëllimit të dëmshpërblimit sipas nenit 643 të këtij Kodi.

Dëmi pasuror sjell si pasojë cenimin e pasurisë së të dëmtuarit në kuptimin e ngushtë ekonomik, pra humbjen e pasurisë (*deminutio patrimonii*) në mënyrë të paligjshme. Prandaj edhe dëmshpërblimi i

dëmit pasuror ka për qëllim të rikthejë pasurinë e të dëmtuarit në gjendjen e mëparshme, duke “mbushur” diferencën e krijuar ndërmjet gjendjes ekonomike aktuale të tij, me atë në të cilin do të ndodhej nëse nuk vërtetohej fakti i paligjshëm (*quanti ea res erit, tantam pecuniam condemnato*).

Lidhur me dëmin pasuror, nenet 486 dhe 640 të Kodit Civil dallojnë humbjen e pësuar nga pakësimi i pasurisë, që njihet si dëmi aktual apo dëmi emergjent (*damnum emergens*) dhe fitimin e munguar (*lucrum cessans*). Në parim, dallimi ndërmjet dëmit emergjent (*quantum mihi abest*) dhe fitimit të munguar (*quantum lucrari potui*), qëndron në aktualitetin ose jo të interesit pasuror të cenuar. Në rastin e parë objekt i dëmit është pakësimi, humbja e një interesi pasuror aktual, pra e një pasurie që i përket (*in re ipsa*) të dëmtuarit në çastin e shkakut të dëmit. Në rastin e fitimit të munguar kemi të bëjmë me pamundësinë e përfitimit të një interesi pasuror të ardhshëm, pra të një pasurie që ende nuk i përket të dëmtuarit në çastin e shkakut të dëmit.

Në gjykim, paditësit Xhafer e Athina Alimadhi dhe paditësit Hysen e Klarita Baliqi, në mbështetje të shkronjës “a” të nenit 643 të Kodit Civil kanë kërkuar të dëmshpërblehen për dëmin pasuror në formën e shpenzimeve për ushqim e jetesë për shkak të vdekjes së fëmijëve të tyre të mitur nga fakti i paligjshëm, aksidenti automobilistik.

Dispozita e shkronjës “a” të nenit 643 të Kodit Civil parashikon se kur shkaktohet vdekja e një personi, dëmi që duhet të dëmshpërblehet përbëhet nga: “a) shpenzimet për ushqim dhe jetesë të fëmijëve të tij të mitur, të bashkëshortes dhe prindërve të paaftë për punë që kanë qenë në ngarkim të të vdekurit, plotësisht a pjesërisht, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit.”

Gjykatat e faktit, duke bërë një interpretim të gabuar të kësaj dispozite, si dhe të neneve 192, 198, 201 dhe 210 të Kodit të Familjes, kanë arritur në përfundimin se ajo nuk gjen zbatim nëse viktimja është i mitur. Ato arsyetojnë se i mituri, për shkak të moshës e ndalimit ligjor për të punuar, pra edhe pamundësisë për të krijuar të ardhura të ligjshme, nuk ka kapacitet ligjor për të marrë përsipër dhe nuk mund të ngarkohet me detyrime për ushqim kundrejt të afërmeve të tij.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se vdekja e fëmijës nga një fakt i paligjshëm përbën një ngjarje dëmi, e cila, përveç pasojave të rënda morale e ndjesore, presupozon humbjen e mbështetjes ekonomike dhe të përkujdesjes, të cilën, sipas rrjedhës shkakësore normale dhe të zakonshme, nëse do të arrinte moshën madhore, viktimja i mitur do ta ofronte në të ardhmen kundrejt pasjetuesve familjarë të afërm të tij (*ablata causa tollitur effectus*).

Për këto arsye, prindërit e viktimës kanë humbur mundësinë dhe të drejtën, respektivisht edhe detyrimin e fëmijës, në të ardhmen, për të gëzuar e përfituar përkujdesjen e tij, raporte që gjejnë zbatim edhe në lidhje me pjesëtarë të tjerë të familjes së viktimës (neni 192 i Kodit të Familjes). Në veçanti, me humbjen e jetës, krahas përkujdesjes, viktimja i mitur nuk mund të kontribuojë më, me të ardhurat që do të siguronte në të ardhmen, në mbajtjen e familjarëve pasjetues me të cilët kishte lidhje gjinore (familjare) shumë të afërt dhe një bashkëjetesë të qëndrueshme, ekonomike dhe afektive (neni 163 i Kodit të Familjes). Nga ana tjetër, këtë mungesë përkujdesjeje dhe kontributi detyrohen ta kompensojnë në të ardhmen, moralisht edhe ekonomikisht, anëtarët e tjerë të familjes. Prandaj këta legjitimohen të kërkojnë dëmshpërblimin e dëmit pasuror sipas nenit 643/a të Kodit Civil si një fitim i munguar, pra si pamundësi për realizimin e përfitimeve të ligjshme pasurore në dobi të tyre në të ardhmen.

Arsyetimi i mësipërm gjen mbështetje në detyrimin kushtetues për respektimin e dinjitetit të të drejtave dhe lirive të njeriut të parashikuara nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta, në nenin 3, i vendos ato në bazat e shtetit shqiptar, “i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.” Edhe neni 15 parashikon se: “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të gjithë rendit juridik.” Më konkretisht, paprekshmëria e familjes, në çdo aspekt të vetë qëllimit dhe ekzistencës së saj, gjen mbrojtje të posaçme kushtetuese në nenin 53, pikat 1 dhe 2, ku parashikohet se: “1. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje. 2. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.”

Në këtë drejtim, edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, në nenin 8 të saj parashikon se: “Çdo njeri ka të drejtë që të respektohet në jetën e tij private dhe familjare...”. Neni 12 sanksionon për të gjithë të drejtën themelore të njeriut që “...të martohen dhe të krijojnë familje...”. Ndërkohë që neni 13 parashikon se: “Çdo njeri të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë ka të drejtën e një mjeti efektiv mbrojtës përpara një autoriteti kombëtar...”

Nga sa më sipër buron jo vetëm realiteti, por edhe nevoja e ndërgjegjësimit të shoqërisë se familja, përveçse një njësi prodhuese të ardhurash të matshme në para, është mbi të gjitha njësi e shoqërisë që prodhon shërbime e përkujdesje reciproke për anëtarët e saj. Prandaj si e tillë, cenimi i familjes në çdo formë legjitimon të drejtën e shtetit për ta mbrojtur atë, por edhe të drejtën e anëtarëve të familjes për t'u dëmshpërblyer në rrugë gjyqësore, nëse cenohen në këto të drejta themelore.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: **Në mbështetje të neneve 608 dhe 643/a të Kodit Civil, anëtarët pasjetues të familjes, në lidhje të afërt dhe të qëndrueshme me të ndjerin e mitur që ka humbur jetën për shkak të një fakti të paligjshëm, kanë të drejtën e dëmshpërblimit në lidhje me dëmin pasuror të pësuar në formën e fitimit të munguar, si një pamundësi për të përfituar, në rrjedhën normale të jetës, solidaritetin dhe kontributin reciprok të të ndjerit të mitur, jo vetëm si përkujdesje në tërësi, por edhe si mbështetje ekonomike e tij për familjen në të ardhmen. Për efekt të legjitimitetit aktiv për kërkimin e dëmshpërblimit nuk ka rëndësi rrethana që në kohën e vdekjes së të miturit, prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes gëzojnë ose jo të ardhura të mjaftueshme për ushqim dhe jetesë.**

“E drejta e mbajtjes” (ushqimit) në familje, e parashikuar edhe në shkronjën “a” të nenit 643 të Kodit Civil, në pjesën “... si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit.”, duhet të zbatohet nga gjykata duke respektuar detyrimet që burojnë nga normat kushtetuese e ligjore të trajtuara më sipër. Kjo dispozitë, në pjesën e sipërcituar, përfshin edhe rastet kur viktimja, madhor apo i mitur, ishte pjesëtar i “familjes” e “banonte” me pasjetuesit, pavarësisht se nuk ka qenë i ngarkuar sipas legjislacionit familjar me ndonjë detyrim konkret për ushqim ndaj tyre a personave të tjerë në ngarkim të tij. Pikërisht këta pasjetues, pjesëtarë të familjes së tij, gëzojnë të drejtën e mbajtjes (të ushqimit) nga viktimja. Ligjvënësi nuk ka parasysh vetëm rastet kur ushtrimi i kësaj të drejte apo përmbushja e detyrueshme e saj, përkatësisht, të jetë realizuar apo kërkuar në kohën kur ishte gjallë viktimja, as edhe ekzistencën ose jo në atë kohë të mundësive ekonomike për të kontribuar, të së drejtës dhe aftësisë së viktimës për të punuar, aftësisë për të prodhuar të ardhura, të cilat mund të përbënin a do të përbënin në të ardhmen kontribut edhe në funksion të mbajtjes së familjes.

Për kërkimin e dëmshpërblimit sipas nenit 643/a kanë legjitimitet aktiv pjestarët e familjes (përfshirë bashkëjetuesin *more uxorio*) që gëzojnë të drejtën e mbajtjes, pra të ushqimit e jetesës, deri në çastin e vdekjes së viktimës. Ata kanë barrën e provës të vërtetojnë në gjykim, me çdo mjet provues procedural civil, sipas rrethanave, lidhjen familjare, solidaritetin dhe marrëdhëniet e qëndrueshme me të ndjerin në familje, si dhe masën e kontributit të mundshëm e të pritshëm të tij në të ardhmen për nevojat e familjes. Nëse i ndjeri nuk ka qenë në marrëdhënie pune ose ishte i pasiguruar ose ka qenë në një moshë të mitur, si kriter ligjor për llogaritjen e të ardhurave të tij të pritshme zbatohet ai i parashikuar nga neni 646 i Kodit Civil.

Meqenëse dëmshpërblimi i kërkuar sipas nenit 643/a të Kodit Civil është dëm pasuror në formën e fitimit të munguar, pasi të ketë vërtetuar lidhjen shkakësore materiale mes sjelljes së paligjshme me faj të shkaktesit të dëmit dhe pasojës së dëmshme, paditësit familjarë të viktimës kanë barrën e provës të vërtetojnë me prova pozitive mundësitë konkrete, efektive, të kontributit ekonomik të viktimës në të ardhmen që s'mund të realizohet më si rrjedhojë e faktit të paligjshëm (*quantum debeatur*). Gjykata i çmon këto pretendime në funksion të përcaktimit të llojit konkret të dëmit e të vlerës së tij, sipas parimit të rregullshmërisë dhe efikasitetit shkakësor juridik.

Në çështjen objekt i këtij gjykimi, vetëm përsa i përket caktimit të masës së dëmshpërblimit sipas nenit 643/a të Kodit Civil, meqenëse lidhur me faktin e paligjshëm gjen zbatim edhe legjislacioni i posaçëm për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, gjykata duhet të caktojë dëmshpërblimin e përfitueshëm nga vdekja e fëmijëve të paditësve Alimadhi e Buliqi sipas kriterëve të nenit 27 të rregullores së Ministrisë të Financave. Por, njëkohësisht, gjykata të mbajë parasysh se kjo dispozitë nuk imponon një vlerë të fiksuar të dëmshpërblimit, përderisa parashikon se “*e ardhura që duhet të merret parasysh për llogaritjen e dëmshpërblimit, sidoqoftë, nuk mund të jetë më e ulët se trefishi i shumës vjetore të pensionit më të ulët....*”. Në këtë kuptim, gjykata ka detyrimin t'i përmbahet vetëm kufirit minimal të treguar nga norma, duke çmuar, sipas rrethanave të çështjes, caktimin ose jo të një vlere më të lartë të ardhurash sesa shumja vjetore e mësipërme. Nëse kërkon një dëmshpërblim më të lartë, është paditësi që ka barrën e provës të vërtetojë një pretendim të tillë (*onus probandi incumbit actori*).

6. Në rekurs palët paditëse pretendojnë se duke zbatuar gabim ligjin gjykatat e faktit kanë rrëzuar

padinë lidhur me kërkimin e dëmshpërblimit për *dëmtime të shëndetit* që ata vetë kanë pësuar si rrjedhojë e vdekjes së bijve të tyre nga aksidenti rrugor. Sipas rekursuesve, në interpretim të nenit 625/a të Kodit Civil, “*dëmtimi i shëndetit*” të tyre përfshin jo vetëm gjendjet patologjike, por edhe dëmet morale, pra vuajtjet shpirtërore dhe cenimet e marrëdhënieve që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës së tyre.

Gjykatat pranojnë se humbja e jetës së fëmijës është ngjarje e rëndë dhe mjaft e dhimbshme, që rëndon gjendjen shpirtërore të të afërmeve të tyre. Por, sipas nenit 18 të dekretit nr.295, datë 15.9.1992, dëmshpërblehet vetëm “*vdekja, dëmtimi i shëndetit dhe dëmet pasurore...*”, nëse janë pësuar nga vetë viktimat a të dëmtuarit e përfshirë në një aksident automobilistik. Madje, në zbatim të dispozitave të këtij dekreti, në mënyrë taksative, dëmshpërblehen vetëm dëmet pasurore, ku gjykata përfshin edhe dëmtimin e shëndetit, dhe përjashtohen dëmet jopasurore sipas nenit 625 të Kodit Civil.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se ky qëndrim vjen në kundërshtim me normat dhe frymën e Kushtetutës, qëllimin dhe përmbajtjen e dispozitave të Kodit Civil dhe atyre të legjislacionit të posaçëm për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së mbajtësve të mjeteve motorike ndaj personave të tretë. Edhe në praktikën gjyqësore, në zbatimin e dispozitave të lartpërmendura, konstatohen qëndrime të ndryshme dhe konfuze mbi kuptimin e format e dëmit jopasuror, rrethin e subjekteve që kanë legjitimitim aktiv, kriteret e pranueshmërisë dhe të caktimit të masës së dëmshpërblimit, me tendencë kufizimin e fushës së zbatimit të tyre. Prandaj Kolegjet e Bashkuara çmojnë të nevojshme mbajtjen e një qëndrim të unifikuar rreth këtyre çështjeve.

Dispozita e nenit 625 të Kodit Civil interpretohet e zbatohet në pajtim dhe harmoni me parimet themelore kushtetuese mbi të drejtat e njeriut, duke mbajtur parasysh dhe reflektuar në gjykim edhe vetë procesin dinamik të ndërgjegjësimit e të emancipimit të shtetit e të shoqërisë në njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Sikurse është trajtuar më sipër në këtë vendim, sipas neneve 3, 15 e vijues të Kushtetutës, parashikohet *mbrojtje e posaçme dhe e barabartë* e të mirave pasurore dhe atyre jopasurore të njeriut. Në këtë kuptim edhe neni 608 e vijues i Kodit Civil synojnë riparimin e plotë të çdo dëmi të pësuar në mënyrë të paligjshme, pra jo vetëm në pasurinë në kuptimin e ngushtë ekonomik, por edhe në të mirat jopasurore që mëshirojnë *vlerat e vetë njeriut*.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: **Dëmi jopasuror, i parashikuar në nenin 625 të Kodit Civil, si një kategori e gjerë dhe gjithëpërfshirëse e dëmeve jashtëkontraktore, përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi të drejtpërdrejtë ekonomik në treg. Në thelbin e saj, kjo dispozitë njeh të drejtën e dëmshpërblimit për çdo lloj dëmi jopasuror jashtëkontraktor, i cili është “i ndryshëm nga ai pasuror”. Renditja e “rasteve” të dëmit jopasuror në paragrafët “a” dhe “b” të saj, nuk ka për qëllim të kufizojë, por të rregullojë në mënyrë të shprehur, për efekte të dallueshmërisë së cenimeve, të drejtën e dëmshpërblimit përkatës dhe rrethin e subjekteve që gëzojnë legjitimitim aktiv.**

Në këtë kuptim, dispozita e nenit 625 të Kodit Civil bën dallimin ndërmjet dy grupeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që nuk kanë natyrë pasurore të mbrojtura prej saj në rast cenimi: “*dëmtimi i shëndetit*” (e drejta absolute për shëndetin – në kuptimin biologjik) dhe cenimi i “*personalitetit*” (tërësia e të drejtave absolute të personalitetit). Nisur nga natyra specifike e të drejtave që mbrohen, në paragrafët “a” dhe “b” të nenit 625 ligjvënisi ka parashikuar dy raste të posaçme të dëmit jopasuror në personalitetin e njeriut: “*cenimi i nderit*” dhe “*fyerja e kujtimit të një të vdekuri*”.

Sipas doktrinės e praktikës sonë gjyqësore dhe asaj ndërkombëtare, dëmtimi i shëndetit është figurë autonome e dëmit jopasuror, e ndryshme nga dëmi pasuror për “*humbjen dhe pakësimin e aftësisë për punë*” (neni 641 i Kodit Civil). Ndërsa në grupimin e dytë përfshihen dy figura të dëmit jopasuror, autonome nga njëri-tjetri, dëmi moral dhe dëmi ekzistencial.

Lidhur me rrethin e subjekteve që legjitimohen për kërkimin e dëmshpërblimit të dëmit jopasuror, këtë të drejtë e gëzon cildo që vërteton lidhjen shkakësore juridike ndërmjet faktit të paligjshëm të të tretit dhe dëmit të pësuar në të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme jopasurore.

7. Në rekurs paditësit pretendojnë se në zbatim të gabuar të ligjit gjykatat kanë rrëzuar kërkimin e padisë për dëmshpërblimin e dëmtimeve të shëndetit. Lidhur me këtë pretendim, nga shqyrtimi i padisë, shpjegimet dhe provat e parashtruara në kërkimet dhe prapësimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe qëndrimi ligjor i mbajtur nga gjykatat, Kolegjet e Bashkuara konstatojnë qëndrime të gabuara e paqartësi në interpretimin e zbatimin e drejtë të ligjit, përse i përket figurës së dëmtimit të shëndetit si dëm jopasuror e

dallimit të tij nga dëmet e tjera pasurore që lidhen me këtë lloj dëmi. Qëndrime të tilla vërehen edhe në zgjidhjen e çështjeve analoge në praktikën gjyqësore.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara, duke ushtruar të drejtën dhe detyrimin për të treguar dispozitat konkrete të së drejtës objektive që zgjidhin mosmarrëveshjen në gjykim sipas parimit procedural civil *iura novit curia*, njëkohësisht çmojnë se është vendi për të mbajtur qëndrim të unifikuar mbi kuptimin e “dëmtimit të shëndetit” të parashikuar në nenin 625/a të Kodit Civil, kriteret e vërtetimit dhe caktimit të dëmshpërblimit, si dhe dallimin e tij nga dëmi pasuror i humbjes a pakësimit të aftësisë për punë që rrjedh si pasojë vijuese, e pandërprerë, e këtij dëmi, parashikuar në nenin 641 të Kodit Civil.

Dëmtimi i shëndetit vjen si pasojë e cenimit të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut. Të drejtat e njeriut për jetën dhe shëndetin janë të drejta objektive që lindin dhe janë të padhunueshme e të pandashme me vetë ekzistencën e tij. Prandaj të tilla ato mbrohen e garantohen si të drejta themelore të njeriut nga Kushtetuta (nenet 3, 15/1 dhe 21). Mbrojtja e shëndetit të njeriut mëshirohet jo vetëm në detyrimin e shtetit për kujdesin shëndetësor (nenet 15/2 dhe 56), por edhe në të drejtën për të realizuar këtë mbrojtje në gjykatë (neni 42/2), ndërmjet të tjerave, duke detyruar cilindo që cenon integritetin e tij fizik e psikik të dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar.

Ndërmjet fushave të së drejtës objektive që sanksionojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga veprimet a mosveprimet e paligjshme të të tretit, edhe në Kodin Civil, posaçërisht në shkronjën “a” të nenit 625, parashikohet se: “*Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të dëmshpërblehet kur... a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit...*”.

Dëmtimi i shëndetit, i njohur nga jurisprudenca edhe si “*dëmi biologjik*” apo “*dëmi mbi shëndetin*”, është figurë e posaçme e dëmit jopasuror dhe si i tillë, objekt kërkimi i pavarur të dëmshpërblimit përkatës. Në dallim nga dëmet pasurore, dëmi biologjik nuk ka vlerë ekonomike në tregun e lirë, cenimi i tij nuk kompensohet në natyrë dhe as nuk ka çmim në të holla. Por, për efekt të mbrojtjes së shëndetit, lehtësimit dhe rehabilitimit fizik e social të të dëmtuarit në të ardhmen, personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit biologjik detyrohet t’i paguajë atij një dëmshpërblim në të holla, në mënyrë të pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore që eventualisht i dëmtuari ka pësuar për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm.

Për arsyet e mësipërme, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se: **Dëmtimi i shëndetit (dëmi biologjik) përbën, në thelb, cenimin e së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut. Ky dëm jopasuror, i parashikuar nga shkronja “a” e nenit 625 të Kodit Civil, është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësuar nga i dëmtuari për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm.**

Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: **Meqenëse jeta dhe shëndeti i njeriut nuk ka çmim, në respektim të parimit themeltar kushtetues të barazisë përpara ligjit dhe ndalimit të diskriminimit sipas nenit 18 të Kushtetutës, gjykata duhet të garantojë një gjykim uniform dhe vlerësim të njëjtë të përqindjes e të masës së dëmshpërblimit të dëmit biologjik, për çdo formë e shkallë konkrete të cenimit të përhershëm a përkohshëm të integritetit fizik ose psikik të të dëmtuarit, nëse mosha është e njëjtë dhe po i njëjtë është edhe lloji i dëmtimit shëndetësor fizik a psikik të pësuar.**

Dëmi biologjik, duke qenë cenim në integritetin fizik dhe/ose psikik të njeriut, është objektivisht i vërtetueshëm. Prandaj, në zbatim të rregullave parimore të neneve 2, 6, 29 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*da mihi factum, dabo tibi ius*), i dëmtuari që kërkon dëmshpërblimin ka barrën e provës të vërtetojë se dëmi ka ndodhur, si dhe lidhjen shkakësore të tij me faktin e paligjshëm. Përveç kësaj, gjykata kërkon mendimin e specializuar të ekspertëve mjeko-ligjorë, në shërbim të arritjes së përfundimeve përkatëse sipas bindjes së saj të brendshme për vërtetimin ose jo të shkaktimit të dëmit biologjik, lidhjes shkakësore juridike të tij me faktin e paligjshëm, si dhe për përcaktimin e llojit dhe shkallës përkatëse të dëmtimit, në përqindje për dëmtimet e përhershme dhe në ditë për ato të përkohshme.

Në funksion të garantimit të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe uniformitetit të gjykimit, për caktimin e shkallës së dëmtimit të shëndetit dhe masës respektive të dëmshpërblimit, në parim, gjykatat dhe ekspertët i referohen kriterëve teknike tabelare të parashikuara për këtë qëllim apo për situata të ngjashme në akte normave. Në mungesë të tyre gjykata vendos me drejtësi sipas bindjes së saj të brendshme, duke konsideruar metodologji të tjera të njohura për këtë qëllim, pasi të ketë marrë mendimin e ekspertit

mjeko-ligjor e të atij financiar. Posaçërisht, në rastin e aksidenteve motorike, për caktimin e masës së dëmshpërblimit, referimi bëhet në kriteret teknike tabelare që përmbajnë shkallën e dëmtimit, moshën e të dëmtuarit, njësinë bazë të vlerësimit të dëmit dhe koeficientin korrektues jetësor përkatës, të miratuara për këtë qëllim nga Ministri i Financave në zbatim të nenit 16 të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 (miratuar me ndryshime).

Në vijim, nisur nga arsyetimet e mësipërme, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë edhe në përfundimin unifikues se: **Dëmshpërblimi për dëmtimin e shëndetit sipas nenit 625/a të Kodit Civil kërkohet në mënyrë të pavarur nga kërkimi për dëmin pasuror të humbjes ose pakësimit të aftësisë për punë i parashikuar në nenin 641 të Kodit Civil. Sipas kësaj dispozite, interesi pasuror i cenuar përkohësisht apo përgjithmonë si rrjedhojë e dëmtimit të shëndetit nga fakti i paligjshëm, është e drejta e njeriut e parashikuar në nenin 49 të Kushtetutës, për të fituar mjetet e jetesës, pra edhe për të garantuar e shtuar pasurinë, nëpërmjet punës së ligjshme të zgjedhur me vullnetin e lirë të tij. Njëkohësisht, përbën interes të ligjshëm të cenuar edhe pakësimi i pasurisë së të dëmtuarit në formën e shpenzimeve që ai përballon për përkujdesje dhe, në veçanti, për mjekimin e shëndetit të cenuar si rrjedhojë e pandërprerë e të njëjtit fakt të paligjshëm.**

Meqenëse ky lloj dëmi pasuror është një dëm i ardhshëm në formën e fitimit të munguar (*lucrum cessans*), legjitimohet për kërkimin e tij edhe personi që është i mitur apo nuk është në marrëdhënie pune ose nuk është i siguruar, pra i dëmtuari që nuk siguronte të ardhura në kohën e vërtetimit të faktit të paligjshëm që ka shkaktuar humbje ose pakësim të përhershëm të aftësisë për punë. Në këtë rast gjejmë zbatim kriteret e parashikuara në nenet 645 deri 647 të Kodit Civil dhe, nëse ngjarja lidhet me një aksident automobilistik, krahas tyre, edhe ato të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 (i miratuar me ligj) dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

I dëmtuari që kërkon dëmshpërblimin sipas nenit 641 të Kodit Civil, pasi të provojë dëmtimin e shëndetit, natyrën e përkohshme a të përhershme dhe shkallën përkatëse të këtij dëmtimi, ka edhe barrën e provës të vërtetojë vlerën e të ardhurave të përealizueshme me prej tij nga humbja apo pakësimi i aftësisë për punë. Njëkohësisht, i dëmtuari ka barrën e provës të vërtetojë edhe lidhjen shkakësore ndërmjet dëmtimit të shëndetit dhe nevojës për përkujdesje e mjekim, si dhe vlerën e shpenzimeve përkatëse. Për të arritur në përfundimet e saj, gjykata kërkon mendimin e specializuar të ekspertëve sipas fushave përkatëse. Nëse caktimi i vlerës së saktë të shpenzimeve për përkujdesje e mjekim rezulton i pamundur apo me kosto të lartë, gjykata vendos me bindjen e saj të brendshme, sipas rrethanave të çështjes.

8. Në rekurs, paditësit pretendojnë se me anë të padisë është kërkuar dëmshpërblim edhe për dëmtimet e shëndetit që kanë pësuar si pasojë e humbjes tragjike të bijve të tyre nga fakti i paligjshëm duke iu nënshtruar përkujdesjes dhe mjekimeve, duke përballuar edhe shpenzimet përkatëse. Veçanërisht, është pretenduar për pasojë më të rënda shëndetësore për paditësen Athina Alimadhi.

Gjykatat kanë rrëzuar padinë për këto kërkime, pa i analizuar konkretisht në vendimet e dhëna, kryesisht me arsyetimin se përbëjnë dëme të pësura nga vetë paditësit dhe jo nga viktimat e aksidentit motorik. Si të tilla, janë dëme që nuk legjitimojnë kërkimin e paditësve sipas dispozitave të Kodit Civil dhe atyre të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 të zbatueshme posaçërisht për mosmarrëveshjen në gjykim. Ato kanë administruar edhe disa prova shkresore të paraqitura nga paditësit, por nuk kanë zhvilluar një hetim gjyqësor të plotë e të gjithanshëm dhe nuk kanë urdhëruar kryerjen e ekspertimeve mjeko-ligjore përkatëse në lidhje me këto pretendime.

Ky qëndrim përbën jo vetëm shkelje të normave procedurale civile (neni 6, 14 e vijues i Kodit të Procedurës Civile) por edhe zbatim të gabuar të ligjit material lidhur me kuptimin e dëmit pasuror e jopasuror dhe lidhjen shkakësore juridike, sikurse është trajtuar më sipër në këtë vendim. Paditësit kanë kërkuar dëmshpërblim për dëmin jopasuror dhe atë pasuror, përkatësisht sipas neneve 625 shkronja “a” dhe 641 të Kodit Civil. Sipas tyre ekziston lidhje shkakësore juridike mes faktit të paligjshëm (aksidentit dhe vdekjes së viktimave) dhe cenimeve të shëndetit që kanë pësuar si prindër të viktimave në formën gjendjeve patologjike, psikike etj.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se ky pretendim i ngritur në rekurs nga paditësit është i mbështetur në ligj. Duke pasur parasysh përfundimet unifikuese të parashtruara më sipër në këtë vendim, Kolegjet konkludojnë se *familjarët e afërt të viktimës gëzojnë legjitimitet aktiv për të kërkuar dëmshpërblim, në cilësinë e të dëmtuarit, për cenime të shëndetit dhe interesave të tjera pasurore e jopasurore të pësura si rrjedhojë e vdekjes së njeriut të tyre të afërm nga fakti i paligjshëm i të tretit*. Në rigjykim, gjykata e

shkallës së parë të zhvillojë hetimin e plotë dhe të gjithanshëm për të arritur në përfundime të mbështetura në prova dhe ligj nëse duhet të pranohet apo rrëzohet ky kërkim i padisë.

9. Kolegjet e Bashkuara çmojnë të mbështetur në ligj edhe pretendimin tjetër të ngritur në rekurs se gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin kur rrëzojnë kërkimin e padisë për shpërblimin e dëmit jopasuror të pësuar nga vetë paditësit si dhimbje shpirtërore e vuajtur dhe cenim i cilësisë së jetës personale e familjare.

Sikurse jeta dhe shëndeti, edhe dinjiteti e paprekshmëria e njeriut në qenien fizike e psikike, paprekshmëria e jetës private, familjare e sociale, e drejta për të gëzuar dhe zgjedhur me vullnet të lirë mënyrën e jetesës, janë të drejta të personalitetit, të drejta absolute të njeriut dhe si të tilla të mbrojtura *erga omnes* në raport me çdo pjesëtar tjetër të shoqërisë. Këto të drejta janë pjesë e themeleve të shtetit e të rendit tonë juridik dhe gëzojnë mbrojtjen më të lartë kushtetuese sipas neneve 3, 15, 18, 21, 42, 49, 52, 53, 54, 55 të Kushtetutës.

Në këtë kuptim edhe dhimbja e brendshme e vuajtja shpirtërore, si dhe cenimi i normalitetit të jetës së njeriut në ekzistencën e tij si individ dhe anëtar i shoqërisë, të shkaktuara nga vepra e paligjshme e të tretit, përbëjnë cenime të vlerave të lartpërmendura të të drejtave të personalitetit të mbrojtura nga Kushtetuta. Në zbatim të tyre, në nenin 625 të Kodit Civil parashikohet e drejta e personit për të kërkuar dëmshpërblim nëse cenohet në “*nderin e personalitetin e tij*”. Këto cenime formësohen në dy lloje dëmsh jopasurore, të sferës jashtëkontraktore: dëmin moral dhe dëmin ekzistencial, ndërkohë që cenimi i “*nderit*” dhe “*fyerja e kujtimin të të vdekurit*” janë shfaqje konkrete të dëmit moral në rrethana specifike e të lidhura ngushtë me vetë personin e lënduar.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: **Dëmi moral** (*pretium doloris ose pecunia doloris*) është shfaqje e brendshme e përkohshme, e turbullimit të padrejtë (*non iure perturbatio*) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson cenime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të tretit ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar. Kjo e drejtë, në cilësinë e të dëmtuarit, i përket individualisht (*ius proprius*) edhe secilit prej familjarëve të afërt të personit që ka humbur jetën apo të cenuar në shëndetin e tij nga fakti i paligjshëm, nëse vërtetohet lidhja e tyre e posaçme familjare, ndjesore dhe e bashkëjetesës. Dëmi moral i pësuar nga vetë të afërmit konsiderohet si pasojë, rrjedhim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i të njëjtit fakt të paligjshëm.

Barra e provës për vërtetimin e dëmit moral është e paditësit. Por, nisur nga natyra subjektive e këtij dëmi dhe veçanërisht nga karakteri, shfaqja e brendshme e tij, vërtetimi i cenimit të personalitetit të të dëmtuarit në turbullime, dhimbje e vuajtje shpirtërore etj. nuk mund të provohet në mënyrë tjetër përveçse duke i vlerësuar *ius receptum* si të mbështetura ligjërisht dhe duke i çmuar si të provuara *ipso iure* me vërtetimin nga paditësi të vetë faktit të paligjshëm të të tretit dhe lidhjes së këtij fakti me cenimin moral të pësuar, sipas parimit të rregullshmërisë shkakësore. Duke qenë provë në formën e prezumimit të thjeshtë, nëse shkaktuesi i dëmit nuk arrin të vërtetojë të kundërtën, ajo merr të njëjtën vlerë e fuqi të plotë provuese sikurse prezumimi ligjor *iuris tantum* (neni 13 i Kodit të Procedurës Civile).

Në rast dëmtimi të shëndetit apo vdekje të të afërmit, sikurse në çështjen objekt i këtij gjykimi, gjykata përcakton, sipas rrethanave të çështjes, rrethin konkret të personave që kanë legjitimim aktiv për të kërkuar individualisht dëmshpërblimin e dëmit moral *ius proprius*. Si rregull, legjitimim aktiv ka secili person që bën pjesë në lidhjen më të afërt gjinore familjare me të lënduarin në shëndetin e tij, përkatësisht me viktimën. Në rrethin e personave që kanë legjitimim aktiv përfshihen, në pozitë të njëjtë me fëmijën e mitur dhe bashkëshortin, përkatësisht, edhe fëmija kur lind i gjallë dhe personi që vërteton ekzistencën e bashkëjetesës së qëndrueshme ndjesore dhe ekonomike (*more uxorio*) me të lënduarin a viktimën. I mbetet shkaktuesit të dëmit barra e provës të vërtetimit të kundërtën.

Në këto raste, i dëmtuari mund të provojë shkaktimin e dëmit moral më anë të prezumimit të thjeshtë se, sa më e afërt është lidhja gjinore familjare apo e bashkëjetesës, aq më i rëndë është edhe turbullimi e dhimbja shpirtërore e të afërmit të të lënduarit apo viktimës, pra aq më e lartë është shuma e dëmshpërblimit moral që duhet t’i caktohet nga gjykata.

Në parim, përveç prezumimit të thjeshtë mbi ardhjen e pasojës morale dhe afërsinë gjinore, për caktimin e masës së dëmshpërblimit, gjykata mban parasysh se çdo individ ka personalitetin e tij, unik dhe të ndryshëm nga të tjerët. Prandaj edhe shkalla e vuajtjes së pasojave morale dhe masa konkrete e

dëmshpërblimit mund të ndryshojë rast pas rasti. Për këtë qëllim, gjykata shqyrton edhe rrethana konkrete të çështjes për të çmuar së pari shkallën efektive të dhimbjes e vuajtjes shpirtërore të shkaktuar dhe, në lidhje me të, natyrën e faktit të paligjshëm apo rrezikshmërinë e saj nëse përbën vepër penale, shkallën e fajësisë dhe në tërësi mënyrën e sjelljes së shkaktuesit të dëmit në raport me ngjarjen dhe personat e cenuar, natyrën e së drejtës së cenuar dhe të pasojave të shkaktuara nga fakti i paligjshëm, kushtet subjektive të të dëmtuarit, si mosha dhe shkalla individuale e ndjeshmërisë ndaj cenimit të pësuar, si dhe rrethanat që lidhen me kushtet sociale dhe ekonomike të të dëmtuarit por pa cenuar në këtë rast parimin kushtetues të barazisë para ligjit dhe të ndalimit të diskriminimit të njeriut për shkak të gjendjes sociale, ekonomike etj. në zbatim të nenit 18/2 të Kushtetutës.

Shuma e dëmshpërblimit për dëmin moral, për shkak të natyrës subjektive dhe të brendshme të tij, nuk mund të llogaritet mbi tabela dhe skema të parallogaritura vetëm për këtë qëllim. Prandaj gjykata e cakton atë mbështetur në parimin e dhënies së drejtësisë sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre, duke u mbështetur edhe në kriteret eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës së të drejtës së cenuar ose, në mungesë të tyre, në kriteret dhe elemente vlerësimi të konsoliduara nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në përvoja përkatëse jashtëgjyqësore, duke pasur gjithnjë parasysh zhvillimin aktual ekonomik e social të vendit, përfshirë vlerën e parasë në ekonominë kombëtare.

Në rastin e dëmit moral që pëson vetë personi i cenuar në shëndetin e tij ose në rastin e dëmit moral *ius proprius* të vuajtur nga të afërmit e tij apo një viktimë, gjykata, për efekte të caktimit të dëmshpërblimit, mbështetet në vlerat përkatëse të paracaktuara në të holla në tabelën e lartpërmendur të dëmshpërblimeve për dëmin biologjik që miratohet sipas dekretit me akt normativ të Ministrit të Financave. Në mungesë të këtyre kriterëve tabelare normative, gjykata vendos me drejtësi sipas bindjes së saj të brendshme. Në mënyrë që të mos jetë simbolik dhe as mjet pasurimi i pajustificuar, dëmshpërblimi për dëmin moral caktohet nga gjykata në kufijtë ndërmjet $\frac{1}{4}$ deri në $\frac{1}{2}$ e shumës së caktuar më parë prej saj si dëmshpërblim për dëmin biologjik të përhershëm ose në vlerë të njëjtë me atë të dëmshpërblimit për dëmin biologjik të përkohshëm. Nëse dëmshpërblimi moral kërkohet për humbjen e jetës së të afërmit, për caktimin e tij sipas raporteve të mësipërme, referimi bëhet në dëmin biologjik “terminal”, në të cilin, nëse mbetet gjallë viktimja, do të përfitonte dëmshpërblim në masën 100% të tij.

10. I mbështetur në ligj është pretendimi i ngritur në rekurs nga paditësit se gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin kur kanë rrëzuar padinë për kërkimin e dëmshpërblimit për cenimin e cilësisë së jetës së tyre nga humbja e jetës së fëmijëve për shkak të aksidentit automobilistik.

Në sferën e cenimeve me natyrë jopasurore në të drejtat e personalitetit të mbrojtura nga Kushtetuta dhe Kodi Civil, përfshihen edhe raste e gjendje të tjera subjektive të natyrës psikofizike që nuk gëzojnë mbrojtje nëpërmjet dëmshpërblimit të dëmit moral dhe atij biologjik. Prandaj në nenin 625/a të Kodit Civil, në kategorinë e dëmit jopasuror, krahas figurave të dëmit në shëndet dhe dëmit moral përfshihet figura tjetër autonome e dëmit ekzistencial, ndryshe dëmi mbi cilësinë e jetës. Dëmi ekzistencial shkaktohet si rrjedhojë e cenimit të vlerave komplekse të padhunueshme të qenies njerëzore, të normalitetit dhe cilësisë së jetës së njeriut, të fushës së ndjenjave dhe të solidaritetit reciprok në kuadër të familjes, si dhe të shprehjes së lirë e të plotë të aftësive të qenies njerëzore për të zhvilluar personalitetin, për t'u shfaqur e realizuar në shoqëri edhe në kuadër të njësisë bazë të saj sikurse është familja (nenet 53 dhe 54 të Kushtetutës).

Prandaj, mbi bazën e këtij arsyetimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se: **Dëmi ekzistencial i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit cenon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thujtë në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjendjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizonin pozitivisht qenien e tij apo mund ta karakterizonin pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga këto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm. Dëmi ekzistencial, duke mos pasur natyrë thjesht ndjesore e të brendshme, është objektivisht të vërtetueshëm.**

Përveç të tjerave, dëmi ekzistencial cenon të dëmtuarin në marrëdhëniet dhe interesat e jetës familjare, sociale, kulturore, sportive, të veprimtarisë zbavitëse, argëtimit, të shlodhjes etj., të cilat çdo individ ka të drejtë t'i gëzojë dhe që ndikojnë në mënyra e shkallë të ndryshme, në varësi të ndjeshmërisë dhe formimit të personalitetit të gjithsecilit, në sferën psikike të të dëmtuarit, duke bërë që të alternohen në një masë të prekshme në kuptimin negativ, duke u shfaqur në botën e jashtme, vetë marrëdhëniet e tij familjare, sociale, kulturore, afektive etj.

Sikurse në çështjen objekt i këtij gjykimi, veçanërisht në rastin e humbjes së jetës së njeriut të afërm në familje apo të dëmtimeve të rënda në shëndetin nga fakti i paligjshëm, marrëdhëniet familjare tronditen thellë, familja privohet e dëmtohet në mënyrë të pariparueshme në elemente të qenësishme të vetë kuptimit dhe ekzistencës së saj, në ndjenjat dhe objektivat e pritshëm për një jetë normale e të konsoliduar, jetë e cila, në mënyrë të papritur e të dhunshme, pëson ndryshime të karakterit përkeqësues për shkak të faktit të paligjshëm të të tretit.

Dëmi ekzistencial, si shfaqje e jashtme e cenimit të interesave të ligjshme lidhur me cilësinë e jetës, ndryshe nga ai moral, është objektivisht i vërtetueshëm dhe nuk mund të provohet vetëm me anë të prezumimeve të thjeshta. Gjykata duhet të pranojë vetëm ato cenime, konkrete, të të drejtave të personalitetit për të cilat ka bërë kërkim dhe që pretendohen nga i dëmtuari si dëm ekzistencial i pësuar prej tij. Duke qenë cenime me natyrë subjektive dhe të lidhura ngushtë me personin e të dëmtuarit, ai ka barrën e provës të vërtetojë me prova pozitive alterimin në kuptimin përkeqësues të ekuilibrit, të zakoneve të jetës dhe vetë ekzistencës së tij personale për shkak të faktit të paligjshëm (*Onus probandi incumbit actori*).

Për caktimin e dëmshpërblimit të dëmit ekzistencial, gjykata çmon mbi rrethana që vërtetojnë ndryshim të dukshëm e të rëndësishëm përkeqësues të jetës së përditshme dhe impaktin aktual e të ardhshëm të këtyre ndryshimeve në interesat jopasurore dhe marrëdhëniet e të dëmtuarit me botën e jashtme. Në veçanti, në rastet e vdekjes apo dëmtimit të rëndë të shëndetit të të afërmit, për caktimin e masës së dëmshpërblimit ekzistencial mbahen parasysh edhe afërsia gjinore, mosha e viktimës dhe e të dëmtuarit, përbërja dhe gjendja e bashkëjetesës në familje, si dhe rrethana të tjera që provojnë përkeqësimin e gjendjes deri në pamundësinë e shprehjes së aftësive të të dëmtuarit për të zhvilluar interesat dhe veprimtarinë e përditshme.

Sikurse ai moral, edhe dëmi ekzistencial ka natyrë subjektive. Prandaj shuma e dëmshpërblimit të tij caktohet në mënyrë të pavarur nga dëmi moral, por duke zbatuar të njëjtat kritere dhe metoda të vlefshme për llogaritjen e dëmshpërblimit të këtij të fundit.

11. Përfundimisht, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se vendimi i gjykatës së apelit duhet të mbetet në fuqi përse i përket pranimit të pjesshëm të padisë. Kjo gjykatë me të drejtë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila, nga ana e saj, ka pranuar pjesërisht padinë për dëmet pasurore në formën e shpenzimeve të varrimit për të gjithë paditësit dhe të shpenzimeve për ushqim e jetesë vetëm për paditësit Yska.

Në lidhje me rrëzimin e kërtimeve të tjera të padisë, vendimi i gjykatës së apelit dhe ai i gjykatës së shkallës së parë duhet të prishen dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë me tjetër trup gjykues, për shkak të kuptimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit material dhe shkeljeve të rënda procedurale.

Në rishqyrtim, gjykata e shkallës së parë, në funksion të dhënies së një vendimi të mbështetur në prova dhe në ligj, ka detyrimin që të sigurojë një procedim provues të rregullt ligjor duke pasur parasysh edhe qëndrimet dhe orientimet e këtij vendimi (neni 4 dhe 14 i Kodit të Procedurës Civile). Fillimisht, gjykata të orientojë palët dhe, pikësepari, paditësin, në çështjet e rregullimit të ndërgjyqësisë, legjitimitetit dhe qartësisht të pretendimeve sipas shkakut ligjor dhe objektit të padisë, për natyrën e provave përkatëse në mbështetje të kërtimeve dhe prapësimeve që janë të domosdoshme në lidhje me natyrën e mosmarrëveshjes në gjykim (neni 9, 17, 158/a dhe 213 i Kodit të Procedurës Civile). Gjykata të lejojë palët ndërgjyqëse të debatojnë dhe provojnë faktet mbi të cilat mbështeten të gjitha kërkimet e padisë dhe prapësimet e tyre, sipas barrës së provës përkatëse (neni 19 dhe 20 i Kodit të Procedurës Civile). Gjithashtu, për shkak të natyrës komplekse të fakteve dhe kërtimeve të padisë, gjykata e shkallës së parë të kryejë edhe ekspertimet përkatëse me ekspertë kompetentë sipas fushave (nenet 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile).

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të shkronjës "ç" të nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë",

VENDOSËN:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.74, datë 24.1.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, përsa i përket pranimi të pjesës së padisë.

Prishjen e këtij vendimi dhe të vendimit nr.1053, datë 28.2.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përsa i përket rrëzimit të pjesës tjetër të padisë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me tjetër trup gjykues.

2. Ky vendim është unifikues për praktikën gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Kryesues: Artan Hoxha.

Anëtarë: Ylvi Myrtja, Gani Dizdari, Nikoleta Kita, Agron A.Lamaj, Perikli Zaharia, Spiro
Spiro, Evjeni Sinojmeri, Irma Bala, Shpresa Beçaj, Ardian Dvorani, Besnik Imeraj, Fatos
Lulo, Ardian Nuni.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 5.3.2008
Doli nga shtypi më 7.3.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2008

Çmimi 20 lekë